



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:103693

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05522747

Ac.nr.6486/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.S. nga fshati ..., Komuna e Suharekës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.B., avokat nga Prizreni, kundër të paditurit L.V. nga fshati ...Komuna e Suharekës, për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.769/18 të datës 30.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.03.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Sh.S. nga fshati ..., Komuna e Suharekës, ANULOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.769/18 i datës 30.10.2020, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, C.nr.769/18 të datës 30.10.2020, e ka hedhë poshtë padinë e paditësit Sh.S. nga Suhareka, e ushtruar kundër të paditurit L.V. nga fshati ... Komuna e Suharekës, në këtë çështje juridike kontestimore.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur paditësi nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, duke e atakuar të njëjtin për shkak të lëndimit qenësor të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa

aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:  
*Ankesa e paditësit është e bazuar.*

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi Sh.S. nga fshati ..., Komuna e Suharekës, ka ushtruar padi kundër të paditurit L.V. nga fshati ...Komuna e Suharekës, për vërtetimin e pronësisë me kërkesë dhe arsye sikurse në padinë e ushtruar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr.769/18 të datës 18.06.2020 e kishte ftuar paditësin që të bëjë pagesën e diferencës së taksës gjyqësore për vlerën e caktuar të kontestit, që gjykatës ti dorëzoj certifikatën e pronësisë për paluajtshmërinë për të cilën kërkon vërtetimin e të drejtës së pronësisë me kërkesëpadi dhe konform kësaj çertifikate të bëjë rregullimin e legjitimitetit pasiv të palës së paditur, duke e njoftuar njëkohësisht edhe për pasojat juridike në rast se paditësi nuk vepron sipas këtij aktvendimi.

Paditësi duke vepruar sipas këtij aktvendimi kishte paguar diferencën e taksës gjyqësore për vlerën e caktuar të kontestit për padinë e ushtruar mirëpo nuk kishte dorëzuar ndonjë parashtrësë tjetër në gjykatë sipas rekomandimeve të dhëna nga gjykata në aktvendimin e sipërcituar.  
Gjykata me Aktvendimin C.nr.769/18 të datës 30.10.2020, e ka hedhë poshtë padinë e paditësit Sh.S. nga Suhareka, e ushtruar kundër të paditurit L.V. nga fshati ...Komuna e Suharekës në këtë çështje juridike kontestimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se meqenëse në shkresat e lëndës nuk ka prova se paditësi kishte vepruar sipas aktvendimit të gjykatës, ndërsa në anën tjetër padisë nuk i është bashkangjitur asnjë dokument me të cilin do të vërtetohet ekzistimi i banesës kontestuese, kush është pronar i saj, apo nëse pronar i banesës së pretenduar është i padituri si person fizik apo ndonjë person juridik, respektivisht paditësi nuk e kishte përmirësuar padinë brenda afatit të dhënë nga gjykata, andaj gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që padia e paditësit të hedhet poshtë konform nenit 99 dhe 102 të LPK-së .

Gjykata e Apelit duke e vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore, pasi që aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 1, lidhur me nenin 102 paragrafi 3 dhe 387 par.1 pika s) të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipërcituara për arsye se dispozita e nenit 102 paragrafi 3 i LPK-së, mund të aplikohet në rastet kur gjykata e shkallës së parë i ka kthyer palës padinë në plotësim për elemente që duhet të përmbaj parashtresa sipas dispozitës së nenit 99 paragrafi 2 i LPK-së, me udhëzime përkatëse se cilat plotësime duhet të zënë vend.

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni neni 182.1 lidhur me nenin 387 par.1 pika s) të LPK-së, ngase me këto dispozita është parapar se: *“me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për t’u zgjidhur shpejt e drejt, gjykata që nga momenti i arritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes me aktvendim vendosë për:.....s) masat për përmirësimin dhe plotësimin e parashtresave”*.

Me dispozitën e nenit 102.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore shprehimisht parashihet se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë”*.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit me shikim në shkresat e lëndës gjenë se gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr.769/18 të datës 18.06.2020 e kishte ftuar paditësin që të bëjë pagesën e diferencës së taksës gjyqësore për vlerën e caktuar të kontestit dhe që gjykatës t’i dorëzoj provat me të cilat do t’i mbështete pretendimet e tija të dhëna në padi, duke e njoftuar njëkohësisht se në rast se paditësi në afatin e caktuar (3 ditësh) nuk i dorëzon gjykatës parashtresën me përmirësimet e rekomanduara dhe taksën gjyqësore do të konsiderohet se ka tërhequr padinë, e në rast se të njëjtin e bënë të pa përmirësuar e njëjta do të hedhet poshtë.

Në rrethanën e tillë sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk kanë qenë të plotësuara kushtet ligjore për hedhjen e padisë ashtu siç gjykata e shkallës së parë ka vendosur me aktvendimin e ankimuar ngase gjykata do të mund të vendoste për hedhjen e padisë si të palejuar nëse do të ishin plotësuar kushtet ligjore nga neni 391 lidhur me nenin 102 të LPK-së, pra nëse paditësi do të kishte dorëzuar parashtresën në gjykatë të pa korrigjuar dhe të paplotësuar, gjegjësisht në rast se paditësi me parashtresën e dorëzuar në gjykatë nuk do t’i kishte evituar të metat. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë e ka hedhë poshtë padinë me arsyetimin se në shkresat e lëndës nuk ka prova se paditësi kishte vepruar sipas aktvendimit të gjykatës për plotësimin dhe korrigjimin e padisë, nga çka rezulton se nuk kanë qenë të plotësuar kushtet për hedhjen poshtë të padisë. Në rast se gjykata do të vlerësonte se paditësi nuk ka vepruar fare sipas rekomandimeve të gjykatës së shkallës së parë për përmirësimin dhe plotësimin e padisë do të duhej që eventualisht të konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë ashtu siç parashihet me dispozitën e sipërcituar ligjore dhe ashtu siç gjykata e ka paralajmëruar paditësin e jo që padia e paditësit të hedhet poshtë, siç ka vepruar gjykata në rastin konkret.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të sipër theksuara, të cilat shkelje në rigjykim duhet të evitohen, në atë mënyrë që nëse edhe më tutje gjykata vlerëson se padia është e parregullt atëherë ajo të marrë aktvendim për plotësimin e padisë, ta udhëzoj palën paditëse në mënyrë të qartë për të dhënat që do të zënë vend me rastin e plotësimit. Gjithashtu gjykata duhet të jetë e kujdesshme me rastin kthimit të padisë në plotësim, në atë mënyrë që padia të kthehet në plotësim vetëm për

elementet për të cilat lejohet kthimi në plotësim, pastaj varësisht nga të gjeturat të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e LPK-së.

Në bazë të rrethanave të lart përmendura, e në mbështetje të dispozitave të nenit/ve 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së , gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.6486/20, datë 27.03.2024

Kryetarja e kolegjit  
Halide Reka d.v